

Ligji Integral me ndryshimet e ligjit Nr. 22/2019 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.. 103/2016 “Për Akuakulturën”

LIGJ Nr. 103/2016

PËR AKUAKULTURËN¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të kontribuojë në nxitjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të industrisë së akuakulturës, nëpërmjet rritjes së konkurrueshmërisë dhe përfitimeve në këtë sektor, duke respektuar zhvillimin e ekuilibruar e të qëndrueshëm mjedisor në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Objekti

Ky ligj përcakton bazën e nevojshme ligjore për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike të prodhimit dhe kultivimit të organizmave ujorë në fushën e akuakulturës në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Akuakulturë" është kultivimi ose mbarështimi i organizmave ujore si peshqit, molusqet, krustacetë dhe bimët ujore nga personat fizikë ose juridikë, nëpërmjet përdorimit të teknologjive të përcaktuara për të rritur prodhimin e tyre përtej

¹ Ky ligj është përafruar pjesërisht me:

Rregulloren (BE) nr. 1380/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11 dhjetor 2013, "Mbi Politikën e Përbashkët të Peshkimit", që amendon Rregulloret e Këshillit (KE) nr.1954/2003 dhe (KE) nr.1224/2009 dhe që shfuqizon Rregulloret e Këshillit (KE) nr.2371/2002 dhe (KE) nr.639/2004 dhe vendimin e Këshillit 2004/585/KE, Numri CELEX 32013R1380, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 354, datë 28.12.2013, faqe 22-61. Rregulloren e Këshillit (KE) nr.199/2008, datë 25 shkurt 2008, "Mbi vendosjen e një kuadri të Komunitetit për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshillimin shkencor në lidhje me Politikën e Përbashkët të Peshkimit", Numri CELEX 32008R0199, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 60, datë 5.3.2008, faqe 1-12.

Rregulloren (BE) nr. 508/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 15 maj 2014, lidhur me Fondin Evropian Detar dhe të Peshkimit, dhe që shfuqizon Rregulloret e Këshillit (KE) nr.2328/2003, (KE) nr. 861/2006, (KE), nr. 1198/2006 dhe (KE) nr. 791/2007 dhe Rregulloren (BE) nr. 1255/2011 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, Numri CELEX 32014R0508, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 149, datë 20.05.2014, faqe 1- 66.

kapaciteteve natyrore në mjedis, ndërhyrjes në ciklin e tyre të plotë apo të pjesshëm, në një pjesë të përzgjedhur dhe të kontrolluar të territorit ujor dhe tokësor në Republikën e Shqipërisë;

2. "Akuakulturë biologjike/organike" është aktiviteti që karakterizohet nga:
 - a) reduktimi i ndikimeve negative në mjedis;
 - b) mospërdorimi i hormoneve dhe OMGJ-ve;
 - c) respektimi i dendësisë së kafshëve;
 - ç) respektimi i mirëqenies së kafshëve;
 - d) përdorimi i ushqimeve organike, që rrjedhin nga një peshkim i qëndrueshëm, burime të akuakulturës dhe bujqësisë organike;
 - dh) përdorimi i produkteve të pastrimit, miqësore me mjedisin;
 - e) përdorimi i trajtimit veterinar, kur është i nevojshëm, por pa dëmtuar cilësitë biologjike/organike të kafshëve.
3. "Akuakulturë ekstensive" është një mënyrë prodhimi, në të cilën llojet e kultivuara marrin të gjitha ushqimet nga mjedisi natyral i sistemit ujor ku kultivohen ose nëpërmjet ujit të furnizuar në këtë sistem dhe të karakterizuar nga:
 - a) një shkallë e ulët kontrolli (sikurse i mjedisit, ushqimeve, grabitqarëve, konkurrentëve etj.);
 - b) kosto fillestare të ulët, niveli të ulët të teknologjisë dhe rendiment të ulët prodhues (jo më shumë se 500 kg/ha/vit);
 - c) varësia e lartë nga kushtet klimaterike dhe cilësia e ujit; përdorimi i trupave ujore natyrore (p.sh. laguna, gjire, rezervuarë të bujqësisë) dhe ushqime natyrore, shpesh të papërcaktuara, të organizmave ujorë.
4. "Akuakulturë gjysmë intensive" është një mënyrë kultivimi që ka për qëllim të rrisë prodhimin e peshkut në sistemet ujore, tej nivelit të siguruar nga ushqimi që gjendet në mënyrë natyrale në këto sisteme, nëpërmjet ushqimeve shtesë, që luajnë rol plotësues.
5. "Akuakulturë intensive" është një mënyrë kultivimi, në të cilën të gjitha ushqimet furnizohen nga jashtë dhe që karakterizohet nga:
 - a) prodhimi i më shumë se 30 kg/m³;
 - b) një shkallë të lartë kontrolli;
 - c) kosto fillestare të larta, nivel i lartë i teknologjisë dhe rendiment i lartë në prodhim;
 - ç) tendenca e rritjes së pavarësisë nga kushtet klimaterike dhe nga cilësia e ujit;
 - d) përdorimi i sistemeve artificiale të kultivimit.
6. "Akuakulturë në shkallë të vogël" është një mënyrë kultivimi e përbërë nga një ose me shumë njësi të vogla prodhimi, me menaxhim familjar ose të komunitetit, duke përdorur nivele të ulëta ose mesatare të burimeve dhe punë të kufizuar nga jashtë e shpesh për arsye vetë konsumimi.
7. **"Zonë e përcaktuar për akuakulturë (ZPA)" është një sistem planifikimi hapësinor apo zonimi, i kryer në nivel rajonal ose kombëtar.**
8. "Drejtoria" është drejtoria përgjegjëse në ministri për hartimin e politikave në akuakulturë.
9. "Ekosistem detar/ujor" është një kompleks dinamik, i përbërë nga komunitete të bimëve, kafshëve e mikroorganizmave, si dhe mjedisi jo i gjallë, të cilat ndërveprojnë ndërmjet tyre si një njësi funksionale, sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për peshkimin;
10. "Ujëra të Republikës së Shqipërisë" përfshin ujërat detare, si dhe ujërat e brendshme, sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për peshkimin.
11. "Ujëra të brendshme" janë lagunat bregdetare, liqenet natyrore, liqenet e

- a) hidrocentraleve, ujëmbledhësit e bujqësisë,
 - b) lumenjtë dhe ujëra të tjera të Republikës së Shqipërisë, të ndryshme nga ujërat detare, sipas
 - c) përcaktimit në legjislacionin në fuqi për peshkimin.
12. "Organizma ujorë" janë gjallesat shtazore ose bimore, që kanë ujin si mjedis të zakonshëm ose natyror jetese, ku përfshihen peshqit, krustacetë, molusqet, gasteropodët, ekinodermët, tunikatët, koralet, sfungjerët, amfibët, reptilët ujorë, gjitarët ujorë si dhe vezët, larvat e rasatet e tyre ose prodhime të tjera natyrore, me përjashtim të shpendëve, sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për peshkimin.
 13. "Ujëra territoriale" nënkupton ujërat e zonës detare, sipas përcaktimit në ligjin "Kodi Detar" në fuqi.
 14. "Ministër" është ministri përgjegjës për aktivitetin e peshkimit dhe akuakulturës.
 15. "Ministria" është ministria përgjegjëse për aktivitetin e peshkimit dhe akuakulturës.
 16. "Parimi i qasjes pro ekosistemit për akua-kulturën" është një strategji për integrimin e veprimtarisë së akuakulturës në kuadër të ekosistemit, e tillë që të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm, barazinë dhe ndryshueshmërinë e sistemeve të ndërlidhura ekonomike, shoqërore dhe ekologjike.
 17. "Zhvillimi i qëndrueshëm" është administrimi i organizmave ujorë, duke bërë të mundur mbrojtjen e ekosistemit ujor, në mënyrë të tillë që të garantohet shfrytëzimi i vazhdueshëm i tyre për plotësimin pa ndërprerje të nevojave njerëzore për brezat.
 18. "Instalime tokësore" është tërësia e ndërtimeve që shërbejnë për kultivimin e organizmave ujorë, të tilla si vaskat, kanalet furnizuese dhe shkarkuese, inkubatorët, laboratorët, magazinat frigoriferike, si dhe çdo ndërtim tjetër që shërben për akuakulturë.
 19. Instalime në pronësi shtetërore" është tërësia e ndërtimeve që shërbejnë për kultivimin e organizmave ujorë, të tilla si vaskat, kanalet furnizuese dhe shkarkuese, inkubatorët, laboratorët, magazinat frigoriferike, si dhe çdo ndërtim tjetër që shërben për akuakulturë dhe që janë në pronësi ose në përgjegjësi menaxhimi të një enti shtetëror

KREU II

MIRATIMI I ZONAVE TË PËRCAKTUARA PËR AKUAKULTURË (ZPA)

Neni 4

Qëllimi dhe zbatimi i Zonës së Përcaktuar për Akuakulturë (ZPA)

Zonat e përcaktuara për akuakulturë:

1. Miratohen nëpërmjet një sistemi planifikimi që synon integrimin e aktivitetit të akuakulturës në zonën ujore, bregdetare dhe tokësore me përdoruesit e tjerë, për të shmangur konfliktet në përdorimin e këtyre zonave.
2. Zbatohen për të lehtësuar dhe zhvilluar aktivitetin e akuakulturës në zonën ujore, bregdetare dhe tokësore, duke përfshirë procesin e lejimit dhe të procedurave të funksionimit.
3. I shërbejnë përmirësimit të akuakulturës së qëndrueshme dhe kanë për qëllim koordinimin dhe integrimin e kompetencave e procedurave ndërmjet institucioneve të ndryshme publike, të përfshira në lejimin, kontraktimin dhe monitorimin e aktiviteteve të akuakulturës.

Neni 5

Përgatitja dhe miratimi i ZPA-së

1. ZPA-ja përfshin zona të veçanta, të caktuara, përfshirë edhe instalimet në pronësi shtetërore, me qëllim aktivitetin e akuakulturës, së bashku me infrastrukturën në shërbim të saj.
2. ZPA-ja përgatitet dhe koordinohet me nismën e ministrisë, në konsultim me ministrinë përgjegjëse në fushën e planifikimit të territorit, përdorimin e hapësirës detare dhe tokësore, transportit, përdorimin e burimeve ujore, mbrojtjes së mjedisit, turizmit, ekonomisë dhe trashëgimisë kulturore dhe me organet e pushtetit vendor. Zonat e përcaktuara për akuakulturë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Nëse një ZPA e propozuar shtrihet në një zonë kufitare me një zonë të mbrojtur, procesi i miratimit të saj nga këshilli i Ministrave, duhet të përfshijë një konsultim publik me grupet e interesit dhe institucionet shkencore.
3. ZPA-ja është pjesë e planifikimit fizik të hapësirës ujore dhe tokësore, kriteret për përgatitjen e së cilës mbajnë parasysh faktorët që e lejojnë zhvillimin e akuakulturës dhe ato që nuk e lejojnë zhvillimin e saj.
- 3.1 Janë pjesë e ZPA –së, zonat në të cilat zhvillohet aktiviteti i akuakulturës në struktura në pronësi shtetërore.
4. Me qëllim lehtësimin e dialogut ndërmjet përdoruesve, informacioni mblidhet dhe trajtohet nga ministria në mënyrë administrative, si dhe mbështetet me teknologjinë GIS (Sistemet Informatike Gjeografike) të të dhënave.
5. Të dhënat e përdorura për ZPA-të janë me vlerë jo vetëm për përdoruesit që lidhen direkt me akuakulturën, por për të gjithë përdoruesit publikë detarë dhe tokësorë.

Neni 6

Përmbajtja e ZPA-së

1. Përshtatshmëria e zonave për aktivitet akuakulture identifikohet dhe, bazuar në të, përcaktohen, të paktën, tre kategori zonimi:
 - a) zona të përshtatshme për aktivitetin e akuakulturës;
 - b) zona të papërshtatshme për aktivitetin e akuakulturës;
 - c) zona për aktivitet të akuakulturës me rregulla të veçanta dhe/ose kufizime.
2. Dokumenti i identifikimit ZPA përmban:
 - a) masat e nevojshme për zbatimin e parimit të qasjes pro ekosistemit për akuakulturën;
 - b) masat që lidhen me promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm të saj.
3. Dokumenti për ZPA-në përfshin, gjithashtu, kapacitetet mbajtëse, e mbështetur kjo në studimet përkatëse teknike.

Neni 7

Monitorimi

1. Monitorimi i ecurisë së aktiviteteve të akuakulturës që kryhen në ZPA-të bëhet në mënyrë periodike, të paktën një herë në vit, nga drejtoria përgjegjëse në ministri.
2. Planet e monitorimit përgatiten nga drejtoria përgjegjëse dhe miratohen nga ministri. Ato janë të ndryshueshme, të përshtatura me zhvillimet në kohë dhe hapësirë.

KREU III

VEPRIMTARIA E AKUAKULTURËS

Neni 8

Veprimtaria e akuakulturës

1. Veprimtaria e akuakulturës zhvillohet nga persona fizikë ose juridikë, të cilët kanë akuakulturën për objekt të veprimtarisë, dhe vetëm në sipërfaqet tokësore dhe ujore të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave si ZPA.
2. Personat fizikë ose juridikë, të interesuar për zhvillimin e aktivitetit të akuakulturës në sipërfaqe publike tokësore dhe ujore, u nënshtrohen procedurave të konkurrencës publik, përveçse në rastet kur kontrata rinovohet sipas nenit 25 të këtij ligji. Me fituesin, ministria lidh kontratën për dhënien në administrim të sipërfaqes ujore e limitotrofe ose tokësore për të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës.
3. Personat fizikë ose juridikë, të interesuar për zhvillimin e aktivitetit të akuakulturës në sipërfaqe tokësore private, lidhin me ministrinë kontratë për të drejtën e ushtrimit të aktivitetit, pa iu nënshtroar procedurave të konkurrencës publik.
4. Personat fizikë ose juridikë, të shpallur fitues, pas procedurave të konkurrencës publik apo dhe lidhjes së kontratës me ministrinë duhet të pajisen me licencën me kodin II.3.B, sipas kriterëve dhe procedurave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.
5. Institucioni tjetër, që vlerëson plotësimin e kushteve të licencimit për inspektimin dhe/ose revokimin për veprimtaritë me kodin II.3.B, është Drejtoria dhe Inspektorati i Peshkimit (struktura përgjegjëse për akuakulturën), në ministrinë përgjegjëse për peshkimin.
6. Ndalohet ushtrimi i aktivitetit të akuakulturës nga subjektet fizike ose juridike pa qenë të pajisur me dokumentacionin e përmendur në pikat e mësipërme të këtij neni.

Neni 9

Dhënia me qira e pronës shtetërore ose asaj në pronësi të pushtetit vendor

1. Prona shtetërore ose ajo në pronësi të pushtetit vendor i jepet me qira personave juridikë e fizikë për të ushtruar veprimtarinë e akuakulturës intensive, në bazë të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe sipas procedurave të përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji.
2. Ministria lidh kontratën për të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës me fituesin, pasi ky i fundit të lidhë kontratë me përfaqësuesin e pronës shtetërore ose të bashkisë.
3. Të ardhurat nga qiradhënia për pronën shtetërore derdhen në Buxhetin e Shtetit, ndërsa të ardhurat nga qiradhënia e pronës së pushtetit vendor derdhen në buxhetin e bashkisë.
4. Vlerësimi i tokave shtetërore për qëllime të akuakulturës klasifikohet në të njëjtën kategori me tokat bujqësore.

Neni 10

Dhënia me qira e sipërfaqeve ujore

1. Sipërfaqet ujore të Republikës së Shqipërisë u jepen me qira, sipas procedurave të parashikuara në nenin 8, të këtij ligji, personave juridikë e fizikë, për të ushtruar veprimtarinë e akuakulturës intensive, me qëllim shfrytëzimin e këtyre sipërfaqeve, në bazë të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm.
2. Kushtet e qirasë përcaktohen në kontratën për të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës që ministria lidh me subjektin fitues.
3. Vlerat e qirasë, sipas kategorive ujore, përcaktohen në dokumentin e ZPA-së.
4. Të ardhurat nga qiradhënia derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 11

E drejta e përdorimit

E drejta e përdorimit të tokave në pronësi shtetërore dhe e sipërfaqeve ujore të Republikës së Shqipërisë, për zhvillimin e veprimtarisë së akuakulturës, përcaktohet në kontratën përkatëse për të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës.

Neni 12

Kushtet e kultivimit

1. Personat juridikë dhe fizikë, të cilët kultivimin e kryejnë në instalime tokësore dhe që përdorin ujin e detit, kultivimin e kryejnë vetëm në këtë pjesë tokësore, për të cilën kanë lejen përkatëse, në përputhje me rregullat e ndërtimit dhe me të drejtën përkatëse për ushtrimin e kësaj veprimtarie, nëpërmjet shfrytëzimit të të mirave detare.
2. Personat juridikë dhe fizikë kultivojnë vetëm ato lloje dhe sasi peshku e organizmash të tjerë ujorë, të cilët janë të parashikuar në kontratën për të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës, të lidhur me ministrinë.

Neni 13

Kohëzgjatja e kontratës

1. Kohëzgjatja e kontratës për ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës në sipërfaqet tokësore dhe ujore është deri në 20 vjet. Në varësi të vlerës së investimit, kohëzgjatja e kontratës përcaktohet si më poshtë:
 - a) për investime me vlerë deri në 5 milionë euro, kohëzgjatje deri 10 vjet;
 - b) për investime me vlerë deri 10 milionë euro, kohëzgjatje deri 15 vjet;
 - c) për investime me vlerë mbi 10 milionë euro, kohëzgjatje deri 20 vjet.
2. Në kontratë parashikohen afatet, brenda të cilave duhet të fillojnë e të përfundojnë veprat për ushtrimin e veprimtarisë. Në çdo rast, veprat duhet të përfundohen brenda tre vjetëve nga çasti i nënshkrimit të kontratave përkatëse.

Neni 14

Zhvillimi i aktivitetit në pronat private

1. Personat fizikë ose juridikë, të interesuar për zhvillimin e aktivitetit të akuakulturës tokësore në pronat private, pajisen me kontratën për të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës.
2. Personat fizikë ose juridikë, të interesuar për zhvillimin e aktivitetit të akuakulturës tokësore në pronat private, përpara aplikimit për të drejtën e kultivimit përkatës, lidhin kontratën e qirasë ose të shitblerjes për tokën, pronë private, me pronarin përkatës.

KREU IV

USHTRIMI I VEPRIMTARISË SË AKUAKULTURËS

Neni 15

Autoriteti përgjegjës

Ministria është autoriteti përgjegjës që jep të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës, nëpërmjet lidhjes së kontratës përkatëse me personat fizikë apo juridikë, për ushtrimin e këtij aktiviteti.

Neni 16
Përfitimi i të drejtës së ushtrimit të aktivitetit dhe procedurat e aplikimit

1. Ministria shpall konkurrimin publik për dhënien në përdorim të zonave të përcaktuara në ZPA.
2. Çdo person fizik apo juridik aplikon për të përfitur të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës në zonën tokësore shtetërore/ose private dhe atë detare.
3. Aplikimi kryhet pranë drejtorisë përgjegjëse për akuakulturën.
4. Drejtoria shqyrton aplikimet dhe, në rastin e kërkesës për zonë tokësore shtetërore dhe atë detare, shpall fituesin brenda një periudhe kohore jo më të vonë se 3 muaj nga dita e marrjes së aplikimeve.

Neni 17
Forma e dokumenteve, procedura dhe përmbajtja e kontratës

Forma e aplikimit, ngritja e komisionit të vlerësimit, procedura e konkurrimin, dokumentet që subjektet paraqesin për të marrë të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës, ankimi, si dhe lloji e përmbajtja e kontratës që lidhet ndërmjet palëve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 18
Ndryshimi i të dhënave të subjektit

Në rastet kur subjekti i autorizuar për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës ndryshon të dhënat e tij, atëherë ai duhet të njoftojë ministrinë, e cila ndryshon të dhënat në kontratën përkatëse.

Neni 19
Regjistri i kontratave

1. Drejtoria krijon, mban dhe kujdeset për regjistrin e kontratave të lidhura nga ministria për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës.
2. Kërkesat për krijimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit të kontratave për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës përcaktohen me udhëzim të ministrit.
3. Një kopje e kontratës për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës në sipërfaqet tokësore dhe ujore duhet të disponohet nga subjekti, në vendin ku kryhet aktiviteti i kultivimit ose në selinë e personit fizik ose juridik.

Neni 20
Ndërprerja e kontratës

1. E drejta për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës pushon së ekzistuari:
 - a) kur mbaron afati i kontratës dhe nuk është paraqitur kërkesë për rinovim;
 - b) me pushimin së ekzistuari të personit juridik;
 - c) me kërkesën me shkrim të subjektit, drejtuar ministrisë;
 - ç) në qoftë se pas nënshkrimit të kontratës vërtetohet me fakte se ajo është lëshuar mbi bazën e të dhënave jo të sakta dhe fakteve të pavërteta.
2. Në rast të ndërprerjes së ekzistencës së personit juridik, sipas shkronjës "b", të pikës 1, të këtij neni, subjekti është i detyruar të njoftojë autoritetin që ka dhënë të drejtën e zhvillimit të aktivitetit.

Neni 21

Zgjidhja e kontratës

Kontrata për të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës zgjidhet me vendim, në rastet kur:

- a) përfituesi, sipas kërkesave të këtij ligji, për dy vjet rresht nuk dorëzon të dhënat e përcaktuara në nenin 36 të këtij ligji, dhe aktet nënligjore në fuqi;
- b) subjekti fizik apo juridik kultivon lloje, sasi peshku dhe organizmash të tjerë që nuk janë të përcaktuar në kontratën për zhvillimin e aktivitetit;
- c) së bashku me dënimin me gjobë, për shkelje, vendosen masa mbrojtëse për ndalimin e kultivimit;
- ç) përfituesi/ushtruesi i aktivitetit të akuakulturës nuk ka ushtruar aktivitetin në fjalë pa arsye, për një periudhë më shumë se 12 muaj;
- d) përfituesi nuk ka zbatuar kërkesat e përcaktuara në kontratën përkatëse apo nuk ka përmirësuar pikat e dobëta, që i janë lënë detyrë nga inspektorati i peshkimit, gjatë periudhës së caktuar;
- dh) shkelen kushtet e lejes së mjedisit;
- e) përfituesi nuk ka raportuar për raste sëmundjeje apo për praninë e organizmave të dëmshëm, apo kur ka dështuar për të marrë masat e nevojshme për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve apo të organizmave të dëmshëm në apo rreth zonës së kultivimit, përfshirë këtu dëmtimin e popullatave të peshqve apo organizmave të tjerë detarë;
- ë) përfituesi nuk e ushtron aktivitetin e akuakulturës në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 22

Ndryshimi i kontratës

Në rastet kur janë verifikuar implikime të rënda në mjedis apo në rastet e shfaqjes së sëmundjeve që rezultojnë nga përdorimi i pajisjeve të përdorura, të përcaktuara në kontratë, kërkesat e parashikuara në kontratën për të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës mund të ndryshojnë me mirëkuptim ndërmjet palëve ose me kërkesën e institucioneve përkatëse.

Neni 23

Ankimi

1. Kundër vendimit për zgjidhjen e kontratës, sipas nenit 21, të këtij ligji, si dhe ndërprerjes së saj, sipas shkronjave "c" e "ç", të pikës 1, të nenit 20, të këtij ligji, për të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës, bëhet ankim administrativ, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit/publikimit të tij, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Administrative.
2. Në rastet e ndërprerjes/zgjidhjes së kontratës për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës në sipërfaqen ujore dhe tokësore, autoriteti përgjegjës njofton përfaqësuesin e pronës shtetërore.

Neni 24

Përfundimi i kontratës

1. Kontrata për të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës përmban kohëzgjatjen e përdorimit/qiramarrjes së sipërfaqes ujore e tokësore për këtë qëllim.
2. Pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë së kontratës për të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës, zona shpallet për konkurrim, pasi është marrë më parë edhe mendimi i institucioneve përkatëse, të përfshira në këtë proces, me përjashtim të rastit të përcaktuar në nenin 25, të këtij ligji.

Neni 25

Rinovimi i kontratës

1. Autoriteti përgjegjës, sipas nenit 15, të këtij ligji, miraton rinovimin e kontratës ekzistuese në rastet kur ushtruesi i aktivitetit të akuakulturës e kërkon atë deri në 3 muaj përpara përfundimit të afatit të kontratës.
2. Kërkesa për rinovimin e kontratës për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës refuzohet në rastet kur:
 - a) ushtruesi i aktivitetit nuk ka përmbushur kërkesat për të cilat është lidhur kontrata dhe/ose nuk ka përmirësuar pikat e dobëta gjatë periudhës së ushtrimit të këtij aktiviteti, ashtu sikurse i është kërkuar në kontratën paraardhëse;
 - b) ushtruesi i aktivitetit ka shkelur dispozitat e këtij ligji apo ka vepruar në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në këtë kontratë;
 - c) kërkesa për rinovimin e kontratës nuk është në përputhje me ZPA-në;
 - ç) kërkesa për rinovimin e kontratës bie ndesh me parimet e mbrojtjes së mjedisit, sipas legjislacionit në fuqi;
 - d) ushtruesi i aktivitetit ka pushuar zhvillimin/ushtimin e kësaj veprimtarie.
3. Në rastet kur ushtruesi i aktivitetit të akuakulturës nuk merr përgjigje me shkrim nga autoriteti përgjegjës, sipas nenit 15, të këtij ligji, për mundësinë e rinovimit të aktivitetit brenda afatit 3-mujor, nga data e aplikimit, atëherë e drejta për të ushtruar aktivitetin e akuakulturës konsiderohet si e rinovuar, me të njëjtat kushte dhe terma si ato të përcaktuara në kontratën paraardhëse. Në këtë rast, kontrata e re për ushtimin e aktivitetit të akuakulturës është e vlefshme për një vit, nga dita e përfundimit të vlefshmërisë së asaj paraardhëse.

Neni 26

Transferimi i kontratës për ushtimin aktivitetit të akuakulturës

1. Kontrata për ushtimin e aktivitetit të akuakulturës transferohet te ndonjë person i tretë, fizik apo juridik, vendas ose i huaj, që përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, të përcaktuar në dokumentacionin e tenderit, në bazë të të cilit kontrata ishte dhënë fillimisht, vetëm në rastin kur ka autorizim për këtë transferim, të dhënë më parë, me shkrim, nga autoriteti përgjegjës.
2. Në rast se një person fizik apo juridik dëshiron të marrë të drejtën për ushtimin e aktivitetit të akuakulturës nëpërmjet transferimit, atëherë ai duhet të dorëzojë një kërkesë me shkrim pranë autoritetit përgjegjës.
3. Kërkesa duhet të përmbajë emrin e personit fizik/juridik dhe pëlqimin, me shkrim, të ushtruesit aktual të aktivitetit, për këtë transfertë.
4. Përpara lëshimit të pëlqimit për këtë transferim, drejtoria në ministri mund të kërkojnë të dhëna të tjera apo informacione shtesë, nëse e konsideron të rëndësishme për marrjen e vendimit përkatës, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

5. Të drejtat dhe përgjegjësitë e mbajtësit aktual të kontratës për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës i kalojnë, pas miratimit të transferimit, kërkuesit përkatës.
6. Kohëzgjatja e kontratës për ushtrimin e aktivitetit, në rastin kur transferimi të një person tjetër miratohet, është e njëjtë me atë të parashikuar në kontratën e parë.
7. Nuk lejohet dhënia me nënkontratë e së drejtës për të ushtruar aktivitetin e akuakulturës.

Neni 27

Pronësia e produkteve të akuakulturës

1. Organizmat ujorë, të përcaktuar në kontratën e ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës dhe që ndodhen në zonën ku ky aktivitet ushtrohet, janë në pronësi të subjektit të përcaktuar në atë kontratë.
2. Organizmat ujorë, të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, kur janë larguar nga impiantet e kultivimit ku ushtrohet aktiviteti i akuakulturës, konsiderohen në pronësi të subjektit që ushtron aktivitetin e akuakulturës nëse janë brenda distancës prej 100 m nga kufiri i zonës së përcaktuar në kontratë.

Neni 28

Kultivimi i organizmave ujorë të egër

Në ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës, ku si bazë është përdorimi i organizmave të peshkuar, ministri, me udhëzim, përveç të tjerave, përcakton:

- a) kapacitetin e përgjithshëm të kultivuar, të lejuar për lloje të veçanta;
- b) sasinë maksimale të organizmave ujorë që mund t'i nënshtrohen kultivimit, sipas kontratave përkatëse për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës;
- c) sistemimin e mbikëqyrjes dhe të shoqërimit të kultivimit.

Neni 29

Kultivimi i organizmave joautoktonë

Kultivimi i llojeve joautoktone të organizmave ujorë kryhet vetëm me miratimin e ministrit që mbulon mjedisin si dhe me pëlqimin e institucioneve shkencore të regjistruara për veprimtari kërkimore, para lidhjes së kontratës.

Neni 30

Kultivimi i organizmave të mbrojtur

Kultivimi i llojeve të mbrojtura të organizmave ujorë kryhet vetëm për qëllime ripopullimi, duke zbatuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e biodiversitetit.

Neni 31

Kërkimi shkencor

1. Me qëllim kërkimin shkencor, në zonat e akuakulturës lejohen të zhvillohen aktivitete si përjashtim i dispozitave të këtij ligji.
2. Aktivitetet, sipas pikës 1, të këtij neni, mund të kryhen vetëm me autorizim të veçantë të ministrit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar.

Neni 32
Entet e njohura të kërkimit

Ministri, në bazë të kërkesës, mund të njohë si ent kërkimi shkencor një subjekt publik ose privat, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar.

Neni 33
Aftësia profesionale për kultivim

1. Personat juridikë ose fizikë, veçanërisht ata që do të zhvillojnë aktivitetin e akuakulturës intensive, mund të ushtrojnë këtë aktivitet vetëm nëse kanë persona të punësuar, teknikisht të aftë për kultivim, të pranishëm në çdo kohë.
2. Në varësi të madhësisë së aktivitetit si akuakulturë intensive, gjysmë intensive, ekstensive ose në shkallë të vogël, llojit të organizmave të kultivuar, ndikimit të tij në mjedis, përcaktohet edhe niveli i kualifikimit të personave të punësuar.
3. Ministri përcakton, me udhëzim, nivelin e nevojshëm të kualifikimit për çdo kategori të zhvillimit të aktivitetit.

KREU V
NDIKIMI MJEDISOR

Neni 34
Respektimi i kushteve mjedisore

Çdo subjekt që zotëron të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës, duhet të paraqesë dokumentacionin që vërteton përmbushjen e kushteve mjedisore lidhur me vlerësimin e ndikimit në mjedis, të zonës ku zhvillon aktivitetin dhe të zonës që ndikohet prej tij, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

Neni 35
Kthimi dhe rivendosja në gjendjen fillestare

Kur kontrata për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës nuk është rinovuar, sipas parashikimit në nenin 25, të këtij ligji, apo kur kontrata për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës është zgjidhur, sipas kërkesave të nenit 21, të këtij ligji, atëherë përfituesi i fundit nga kontrata është i detyruar të heqë nga zona të gjitha instalimet, pajisjet apo organizmat e përdorur për ushtrimin e aktivitetit dhe ta kthejë zonën në gjendjen e saj të mëparshme.

KREU VI
GRUMBULLIMI I TË DHËNAVE

Neni 36
Të dhënat për kultivimin

1. Personat juridikë ose fizikë, që kanë marrë të drejtën për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës, janë të detyruar të dorëzojnë në drejtori të dhëna të sakta për aktivitetin, sipas një formulari të përcaktuar nga ministri.

2. Personat juridikë ose fizikë, që kanë kontratë për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës, janë të detyruar të dorëzojnë edhe të dhëna të tjera për aktivitetin e tyre, me kërkesë të ministrisë.

Neni 37

Lloji i të dhënave

1. Të dhënat e grumbulluara janë pjesë e programit kombëtar shumëvjeçar për grumbullimin, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave biologjike, teknike, mjedisore dhe social-ekonomike, të krijuar sipas nenit 93, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar.
2. Të dhënat e grumbulluara mbi bazën e këtij ligji trajtohen njësoj sipas përcaktimeve të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar.

KREU VII

AUTORITETET VENDIMMARRËSE DHE ORGANET KONSULTATIVE

Neni 38

Autoritetet vendimmarrëse/menaxhuese dhe detyrat e tyre

1. Autoritetet vendimmarrëse për çështjet e akuakulturës janë të njëjta me ato të përcaktuara në ligjin e peshkimit në fuqi.
2. Autoritetet vendimmarrëse funksionojnë dhe kanë të njëjtat detyra, sipas përcaktimeve të hartuara në zbatim të nenit 19, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, si dhe të akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.

Neni 39

Organet konsultative

1. Organet konsultative për çështjet e akuakulturës janë të njëjta me ato të përcaktuara në legjislacionin për peshkimin në fuqi .
2. Organet konsultative funksionojnë dhe kanë të njëjtat detyra, sipas përcaktimeve të hartuara në zbatim të nenit 21, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, si dhe të akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.

KREU VIII

POLITIKA STRUKTURE

Neni 40

Fushat e ndërhyrjeve strukturore

1. Politikat strukturore në akuakulturë janë pjesë e politikave të përgjithshme të ministrisë dhe rishikohen, të paktën, një herë në katër vjet.
2. Mbështetja në drejtim të akuakulturës mund të jepet për:
 - a) investime në prodhim;
 - b) masat për mbrojtjen dhe parandalimin e dëmtimit të mjedisit;
 - c) masat për shëndetin publik;
 - ç) masat veterinare.
3. Transferimi i pronësisë së një shoqërie nuk mund të përfitojë mbështetje.

4. Mbështetja e parashikuar në nenet 41, 42, 43 e 44, të këtij ligji, me qëllim garantimin e respektimit të dispozitave në fushën e mjedisit, shëndetit të konsumatorit ose kafshëve, veterinare ose të mirëqenies së kafshëve mund të jepet deri në momentin kur këto dispozita bëhen të detyrueshme për subjektet.
5. Masat e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Neni 41

Mbështetje për investime në prodhim

1. Mbështetja për investime në prodhim mund të jepet për investime që synojnë ndërtimin, zgjerimin, modernizimin e impianteve të prodhimit dhe, në mënyre të veçantë, me qëllim përmirësimin e kushteve të punës, të higjienës, shëndetit të njeriut dhe të kafshëve dhe cilësinë e produkteve, reduktimin e ndikimit në mjedis ose rritjen e efekteve pozitive në mjedis.
2. Mbështetja për investime në prodhim ka për qëllim:
 - a) diversifikimin e kultivimit të llojeve të reja që kanë një treg në zhvillim;
 - b) zbatimin e teknikave të akuakulturës, që reduktojnë ndikimin negativ ose rrisin efektet pozitive në mjedis në mënyrë të ndjeshme, kundrejt teknikave normale të përdorura në akuakulturë;
 - c) vënien në shfrytëzim të tokave të kripura, të varfra apo joproduktive për zhvillimin e aktivitetit të akuakulturës
 - ç) mbështetje për aktivitetet tradicionale të akuakulturës, të rëndësishme për të zhvilluar bazën social-ekonomike dhe mjedisore;
 - d) mbështetje për blerjen e pajisjeve për të mbrojtur impiantet nga kafshët e egra;
 - dh) përmirësimin e kushteve të punës dhe të sigurisë së punëtorëve të sektorit të akuakulturës.
3. Mbështetja për investime, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni, jepet vetëm për rritjen e prodhimit dhe/ose modernizimin e mikro ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ekzistuese, ose për krijimin e ndërmarrjeve të reja.

Neni 42

Mbështetje për masat mjedisore

1. Mbështetja mjedisore në akuakulturë ka për qëllim dhënien e një kompensimi për përdorimin e metodave të prodhimit që kontribuojnë në mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit e të natyrës.
2. Mbështetja mjedisore ka për qëllim të promovojë:
 - a) format e akuakulturës që lejojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit, të burimeve natyrore, diversitetit gjenetik dhe menaxhimit të peizazhit e të karakteristikave tradicionale të zonave të përcaktuara të akuakulturës;
 - b) akuakulturën biologjike, në lidhje me mënyrën e prodhimit biologjik dhe të evidentimit të efekteve të kësaj mënyre mbi prodhimet në treg;
 - c) akuakulturën e qëndrueshme, në përputhje me kufizimet specifike mjedisore që rrjedhin nga përcaktimi i zonës si zonë me status të mbrojtur, në lidhje me mbrojtjen e habitateve natyrore dhe gjysmë natyrore të florës dhe faunës së egër.

3. Me qëllim përfitimin e kësaj mbështetjeje, duhet të vërtetohet që përfituesit, për të gjithë periudhën e ushtrimit të aktivitetit, kanë zbatuar kërkesat e lejes mjedisore, përveç zbatimit të praktikave të mira të akuakulturës. Për të siguruar mbështetjen, sipas pikës 2, shkronja "a", të këtij neni, përfitimet mjedisore të kësaj mbështetjeje duhet të vërtetohen nga një vlerësim paraprak i zbatimit të kushteve të lejes mjedisore.
4. Ministria llogarit nivelin e kompensimit mbi bazën e këtyre kriterëve:
 - a) humbjet e pësuar;
 - b) kostot shtesë, që rrjedhin gjatë periudhës së kalimit nga metodat e prodhimit tradicional në akuakulturë në ato të prodhimit organik;
 - c) nevojës së dhënies së një mbështetjeje për realizimin e projektit;
 - ç) mosavantazhet specifike ose kostot e investimeve për njësitë që ndodhen në brendësi apo në afërsi të zonave me status mbrojtjeje, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Kompensimi nga ministria jepet:
 - a) mbi një shumë të llogaritur për hektar, në zonën në të cilën ndodhen impiantet ku zbatohen masat e veçanta mjedisore;
 - b) për një periudhë jo më të gjatë se dy vjet, gjatë shndërrimit në akuakulturë biologjike;
 - c) për një periudhë jo më të gjatë se dy vjet, pas datës së shpalljes së zonës ku zhvillohet aktiviteti si zonë e mbrojtur, vetëm për subjektet që ekzistojnë para shpalljes së zonës si të tillë.

Neni 43

Mbështetje për masat për mbrojtjen e konsumatorit

1. Mbështetja mund të jepet si kompensim për kultivuesit e molusqeve bivalvorë, për ndalimin e përkohshëm të grumbullimit të molusqeve të kultivuar. Ky kompensim jepet në rastet e ndotjes së molusqeve nga planktoni toksik ose kur prania e tij shkakton, për motive shëndetësore, pezullimin e grumbullimit:
 - a) për një periudhë prej, të paktën, katër muajsh në vazhdimësi;
 - b) në rast se, si rezultat i ndalimit të përkohshëm, dëmi i shkaktuar kalon 25 për qind të xhiros vjetore të subjektit të interesuar, e llogaritur mbi bazën e xhiros mesatare të tri viteve të mëparshme.
2. Në harkun kohor të pesë viteve, kompensimi mund të jepet për një maksimum prej 12 muajsh.

Neni 44

Mbështetje për masat veterinare

Mbështetja mund të jepet për kontrollin dhe eliminimin e sëmundjeve në akuakulturë.

Neni 44/1

Organizatat e prodhuesve

1. Organizatat e prodhuesve të sektorit të akuakulturës krijohen me nismën e prodhuesve të produkteve të akuakulturës dhe të njohura, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar.
2. Një organizatë e prodhuesve që përfaqëson aktivitetet e akuakulturës dhe të peshkimit, mund të krijohet si organizatë e përbashkët e prodhuesve në sektorët e peshkimit dhe të akuakulturës.

3. Kur është e nevojshme, në momentin e krijimit të organizatës së prodhuesve, duhet të mbahet parasysh gjendja specifike e prodhuesve të vegjël

Neni 44/2

Objektivat e organizatave të prodhuesve

1. Organizatat e prodhuesve në sektorin e akuakulturës ndjekin objektivat si më poshtë:
 - a) nxisin realizimin e aktiviteteve të qëndrueshme të akuakulturës të anëtarëve të tyre, me anë të mundësive të zhvillimit, të ofruara në përputhje të plotë me Strategjinë Kombëtare të Peshkimit dhe legjislacionit në fushën e mjedisit, duke respektuar politikën sociale;
 - b) sigurojnë që aktivitetet e anëtarëve të tyre të jenë në përputhje me planet strategjike kombëtare;
 - c) synojnë të sigurojnë që ushqimet për akuakulturën me origjinë nga peshkimi, të vijnë nga peshkimi i menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme.
2. Përveç objektivave të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, organizatat e prodhuesve ndjekin dy ose më shumë objektiva si më poshtë:
 - a) përmirësojnë kushtet për vendosjen në treg të produkteve të akuakulturës së anëtarëve të tyre;
 - b) përmirësojnë performancën ekonomike;
 - c) stabilizojnë tregjet;
 - ç) kontribuojnë në furnizimin me ushqim dhe promovojnë standarde të larta të cilësisë dhe sigurisë ushqimore dhe, në të njëjtën kohë, promovojnë punësimin në zonat bregdetare e rurale;
 - d) zvogëlojnë ndikimin mjedisor të akuakulturës.
3. Organizatat e prodhuesve mund të ndjekin objektiva të tjerë plotësues.”

KREU IX

KËRKESA TË PËRGJITHSHME DHE DETYRIME

Neni 45

Kontrolli

1. Kontrolli për zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij ushtrohet nga drejtoria dhe inspektorati i peshkimit, sipas detyrave, të drejtave dhe përgjegjësi të përcaktuara në ligjin nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar.
2. Të tjera organe dhe institucione mbikëqyrin dhe kontrollojnë këtë aktivitet, sipas kompetencave dhe përgjegjësi që atyre u ngarkohen nga/dhe me ligje të veçanta.
3. Organet përgjegjëse të kontrollit, të ngarkuara nga ky ligj, monitorojnë zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe ushtrojnë kontroll sistematik për masat e marra gjatë ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës.

Neni 46

Dhënia e informacionit dhe kontrolli

1. Personat përgjegjës për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës janë të detyruar që të vënë në dispozicion të organeve përgjegjëse të kontrollit, të përcaktuara nga ky ligj, informacionin e nevojshëm, dokumentet, mostrat, instalimet dhe pajisjet e përdorura, apo materiale të tjera të nevojshme, me qëllim që përfaqësuesit e organeve të kontrollit të mund të ushtrojnë detyrat e tyre në zbatim të këtij ligji.

2. Personat përgjegjës për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës zbatojnë dispozitat përkatëse në fuqi për dhënien e informacionit, duke vendosur në dispozicion zyrat dhe asistencën e tyre për organet e kontrollit.

KREU X SANKSIONET

Neni 47 Kundërvajtjet administrative

1. Përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme:
- a) cilido që zhvillon veprimtari akuakulture në kundërshtim me pikën 5, të nenit 8, të këtij ligji, dënohet me gjobë:
 - i) 50 mijë lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë në shkallë të vogël;
 - ii) 100 mijë lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë ekstensive;
 - iii) 500 mijë lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë gjysmë intensive;
 - iv) 1 000 000 lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë intensive;
 - b) kultivimi i llojeve dhe sasive të peshkut dhe organizmave të tjerë ujorë tej sasive dhe llojeve të shënuara në kontratën për të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës, në kundërshtim me pikën 2, të nenit 12, të këtij ligji, dënohet me gjobë:
 - i) 20 mijë lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë në shkallë të vogël;
 - ii) 200 mijë lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë ekstensive;
 - iii) 200 mijë lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë gjysmë intensive;
 - iv) 500 mijë lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë intensive;
 - c) ushtrimi i veprimtarisë në kundërshtim me dispozitat e nenit pikës 3, të nenit 19, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 5 000 lekë deri në 10 000 lekë;
 - ç) transferimi i kontratës për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës, i paautorizuar më parë, me shkrim, nga autoriteti përgjegjës, ose dhënia me nënkontratë e së drejtës për të ushtruar aktivitetin e akuakulturës, në kundërshtim me dispozitat e pikave 1 dhe 7, të nenit 26, të këtij ligji, dënohet me gjobë:
 - i. 50 mijë lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë në shkallë të vogël;
 - ii. 100 mijë lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë ekstensive;
 - iii. 500 mijë lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë gjysmë intensive;
 - iv. 1 000 000 lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë intensive;
 - d) kultivimi i organizmave ujorë të egër tej kapacitetit të përgjithshëm të kultivuar, të lejuar për lloje të veçanta dhe, sidoqoftë, në kundërshtim me dispozitat e nenit 28, të këtij ligji, dënohet me gjobë:
 - i) nga 100 mijë deri në 150 mijë lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë në shkallë të vogël;
 - ii) nga 200 mijë deri në 250 mijë lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë ekstensive;
 - iii) nga 300 mijë deri në 400 mijë lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë gjysmë intensive;
 - iv) nga 500 mijë deri në 600 mijë lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë intensive, si dhe me sekuestrimin e sasive mbi kapacitetet e lejuara
 - dh) kultivimi i llojeve joautoktone të peshkut dhe organizmave të tjerë ujorë, pa pasur pëlqimin paraprak të ministrisë, në kundërshtim me dispozitat e nenit 29, të këtij ligji, dënohet me gjobë:

- i) nga 200 mijë deri në 250 mijë lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë në shkallë të vogël;
 - ii) nga 300 mijë deri në 350 mijë lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë ekstensive;
 - iii) nga 500 mijë deri në 550 mijë lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë gjysmë intensive;
 - iv) nga 1 000 000 deri në 1 500 000 lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë intensive.
- e) kultivimi i llojeve të mbrojtura të peshkut dhe organizmave të tjerë ujorë pa pasur pëlqimin paraprak të ministrisë, në kundërshtim me dispozitat e nenit 30, të këtij ligji, dënohet me gjobë:
- i. nga 200 mijë deri në 250 mijë lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë në shkallë të vogël;
 - ii. nga 300 mijë deri në 400 mijë lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë ekstensive;
 - iii. nga 500 mijë deri në 600 mijë lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë gjysmë intensive;
 - iv. nga 1 000 000 deri në 1 500 000 lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë intensive, si dhe sekuestrimin e sasive të kultivuara;
- ë) cilido që ushtron veprimtari studimore dhe shkencore pa autorizimin, sipas nenit 31, të këtij ligji, ose në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në autorizim, dënohet me gjobë nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë;
- f) ushtrimi i veprimtarisë në kundërshtim me dispozitat e nenit 34, të këtij ligji, dënohet me gjobë:
- i. 100 mijë lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë në shkallë të vogël;
 - ii. 200 mijë lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë ekstensive;
 - iii. 300 mijë lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë gjysmë intensive;
 - iv. 500 mijë lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë intensive;
- g) Mos largimi nga zona i të gjitha instalimeve, pajisjeve apo organizmave të përdorur për ushtrimin e aktivitetit dhe moskthimi i zonës në gjendjen e saj të mëparshme, pas përfundimit të kontratës ose shfuqizimit të saj, sikurse përcaktohet në nenin 35, të këtij ligji, dënohet me gjobë:
- i. nga 100 mijë deri në 150 mijë lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë në shkallë të vogël;
 - ii. nga 200 mijë deri në 250 mijë lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë ekstensive;
 - iii. nga 300 mijë deri në 400 mijë lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë gjysmë intensive;
 - iv. nga 1 000 000 deri në 10 000 000 lekë, nëse aktiviteti është akuakulturë intensive;
- gj) mosdorëzimi i të dhënave të sakta ose dhënia e të dhënave jo të vërteta apo të falsifikuara, sikurse përcaktohet në nenin 36, të këtij ligji, ose i akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, dënohet me gjobë nga 10 mijë deri në 50 mijë lekë.
2. Të drejtën e gjobës për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në këtë nen, e ka Inspektorati i Peshkimit.
 3. Procedurat e ekzekutimit të gjobave bëhen në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative".
 4. Të ardhurat nga gjobat për kundërvajtjet administrative derdhen 100 për qind në Buxhetin e Shtetit.

Neni 48

Ankimi

1. Ankimi administrativ kundër vendimeve të marra, në lidhje me shkeljen e dispozitave të parashikuara në këtë ligj, depozitohet në ministri, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së njoftimit.
2. Ankimet, sipas pikës 1, të këtij neni, shqyrtohen prej Komisionit të Përhershëm të Ankimeve.
3. Ndaj vendimit të Komisionit të Përhershëm të Ankimeve bëhet ankim në gjykatë, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit.
4. Ministri miraton përbërjen e komisionit, rregulloren e funksionimit të tij, procedurat që ndiqen për shqyrtimin e ankimeve dhe vendimmarrjen, formatin e ankimit, si dhe elementet që duhet të përmbajë kërkesa përkatëse që plotësohet prej ankimuesit.

KREU XI

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 49

Aktet nënligjore

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, nxjerr aktet nënligjore në zbatim të neneve 5, pika 2, dhe 17, brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. Ministri nxjerr aktet nënligjore në zbatim të neneve 19, pika 2; 28; 33, pika 3; 36, pika 1; dhe 48, pika 4, brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 50

Përshtatja me kërkesat e ligjit

1. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, personat fizikë ose juridikë që ushtrojnë veprimtari akuakulture marrin të gjitha masat që të përshtatin aktivitetin e tyre në përputhje me dispozitat e neneve 7, 33, 34, 35 dhe 46, të këtij ligji.
2. Sipërfaqet ujore, për të cilat është lidhur kontratë për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, konsiderohen pjesë e ZPA-së, deri në përfundimin e afatit të kontratës.
3. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, procedurat e konkurrimit publik për të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë së akuakulturës dhe lidhja e kontratave të reja për ushtrimin e saj, sipas pikës 2, të nenit 8, të këtij ligji, pezullohen deri në momentin e miratimit të Zonave të Përcaktuara për Akuakulturën, sipas pikës 2, të nenit 5, të këtij ligji.
4. **Pezullimi i përcaktuar në pikën 3 të mësipërme nuk zbatohet për strukturat pronë shtetërore të kultivimit të midhjeve në Liqenin e Butrintit.**
5. **Kontratat e lidhura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, të cilave u mbaron afati përpara miratimit të ZPA, konsiderohen të vlefshme deri në miratimin e ZPA-së.**

Neni 51

Shfuqizime

Aktet nënligjore, të dala në zbatim të ligjit nr. 7908, datë 5.4.1995, "Për peshkimin dhe akuakulturën", të ndryshuar, mbeten në fuqi deri në momentin e daljes së akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji dhe për aq sa nuk bien në kundërshtim me dispozitat e tij.

Ligji nr. 7908, datë 5.4.1995, "Për peshkimin dhe akuakulturën", i ndryshuar, shfuqizohet, me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Dispozitë kalimtare

1. Pezullimi i përcaktuar në pikën 3, të nenit 50, të ligjit, nuk zbatohet për instalimet, pronë ekzistuese shtetërore të akuakulturës.
2. Kontratat e lidhura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, të cilave u mbaron afati përpara miratimit të ZPA-së, konsiderohen të vlefshme deri në miratimin e ZPA-së, nëse ushtruesi i veprimtarisë së akuakulturës bën kërkesë për zgjatje. Kërkesa për zgjatjen e afatit të kontratës refuzohet në rastet e parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "ç", të pikës 2, të nenit 25, të ligjit.
3. Kontratat e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, mbeten të vlefshme deri në përfundimin e ciklit të prodhimit, por jo më shumë se 18 muaj nga miratimi i ZPA-së

Neni 52 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.10.2016

Shpallur me dekretin nr. 9783, datë 31.10.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani

Miratuar në datën 3.4.2019

Shpallur me dekretin nr. 11176, datë 19.4.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir
Meta